



**UDHËZUES I ORIENTIMIT PËR KARRIERËN TË
NXËNËSVE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT
(KLASAT 6 - 9)**

TETOR 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 6557 / Prot.

Tiranë, më 19.10. 2023

URDHËR

Nr. 600, datë 19.10. 2023

PËR
MIRATIMIN E “UDHËZUESIT TË ORIENTIMIT PËR KARRIERËN TË
NXËNËSVE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT
(KLASAT 6 - 9)”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, pikës 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të urdhrit nr. 565 datë 05.10.2023 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit znj. Nina Guga”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Udhëzuesit të orientimit për karrierë të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6 – 9)”, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Zbatimi i “Udhëzuesit të orientimit për karrierë të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6 – 9)” fillon në vitin shkollor 2023-2024, në klasën e 6-të dhe në klasën e 9-të, ndërsa në vitin shkollor 2024-2025 do të vijojë edhe në klasën e 7-të dhe të 8-të.
3. “Udhëzuesi i orientimit për karrierën” i mëparshëm, i miratuar me nr.246/1 prot., datë 13.01.2023, shfuqizohet.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

Nina Guga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**UDHËZUES I ORIENTIMIT PËR KARRIERËN TË NXËNËSVE NË
ARSIMIN E MESËM TË ULËT
(KLASAT 6 - 9)**

Udhëzuesi i orientimit për karrierën u hartua nga grupi i punës me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) në bashkëpunim me drejtues të shkollave në arsimin bazë.

Grupi punës:

Evis Mastori

Dorina Rapti

Ines Todhe

Erida Koleci

Albana Markja

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
1. KONCEPTI I ORIENTIMIT PËR KARRIERËN NË KLASAT 6- 9.....	8
2. RËNDËSIA E ORIENTIMIT PËR KARRIERËN TË NXËNËSVE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT (KLASAT 6-9)	10
3. EDUKIMI PËR KARRIERËN PËRMES KURRIKULËS ME BAZË KOMPETENCAT 15	
4. VEPRIMTARITË PËR ORIENTIMIN PËR KARRIERËN TË NXËNËSVE NË KLASAT 6-9.....	17
4.1. Veprimtaritë për orientimin për karrierën të nxënësve në klasën e 6-të.....	19
4.2. Veprimtaritë për orientimin për karrierën të nxënësve në klasën e 7-të.....	21
4.3. Veprimtaritë për orientimin për karrierën të nxënësve në klasën e 8-të.....	23
4.4. Veprimtaritë për orientimin për karrierën të nxënësve në klasën e 9-të.....	25
5. PARIME ETIKE TË ORIENTIMIT PËR KARRIERË.....	28
6. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË.....	29
6.1. ROLI I INSTITUCIONIT ARSIMOR	29
6.2. BASHKËPUNIMI ME PRINDËRIT DHE AKTORËT E TJERË.....	36
7. ROLI I ZVAP-ve, DRAP-ve, DPAP-së, ASCAP-it	38
7.1. ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ZVAP).....	38
7.2. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (DRAP)	39
7.3. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (DPAP) 39	
7.4. AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ASCAP).....	40
8. SHTOJCA 1.....	41
9. SHTOJCA 2.....	43
10. SHTOJCA 3	45
11. SHTOJCA 4.....	47

HYRJE

Udhëzuesi i orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9) është një material ndihmës për institucionet arsimore parauniversitare (shkollat) dhe për institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive që mbështesin dhe përgatisin nxënësit, për zgjedhjet dhe vendimmarrjet e tyre për shkollimin e mëtejshëm, kualifikimin, përgatitjen për tregun e punës dhe përzgjedhjen e drejtimeve të karrierës.

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) është e angazhuar të fuqizojë orientimin e nxënësve për karrierën në arsimin e mesëm të ulët (klasat 6 - 9) dhe të nxisë në këtë drejtim punën e bërthamave të karrierës dhe të punonjësve arsimorë në shkolla, pasi e konsideron të rëndësishme mbështetjen sa më herët të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët, në mënyrë që të jenë sa më të informuar dhe të mbështetur në arritjen e vendimeve lidhur me arsimimin e mëtejshëm, kualifikimin, formimin profesional dhe karrierën.

Në ditët e sotme, bota e punës është duke ndryshuar shumë shpejt për shkak të ndryshimeve të shpejta teknologjike, ekonomike dhe sociale. Këto ndryshime kanë krijuar më shumë mundësi sikurse dhe më shumë sfida për çdo individ. Nxënësit po hyjnë në një botë gjithnjë e më komplekse dhe dinamike, ku ndërlihdja midis punës dhe aspekteve të tjera të jetës rivlerësohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ndërkombëtarisht është e shprehur dukshëm rëndësia dhe vëmendja që i kushtohet mbështetjes së nevojshme të të rinjve dhe të rriturve për të hyrë dhe funksionuar në tregun e punës, mbështetur në parimet e të nxënësve gjatë gjithë jetës. Bashkimi Evropian është promotor i të mësuarit gjatë gjithë jetës në mënyrë që qytetarët të përvetësojnë aftësitë e nevojshme për zhvillim personal dhe profesional dhe të përshtaten shpejt me ndryshimet në tregun e punës.

Politikat aktuale për arsimin parauniversitar në Shqipëri dhe Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026, në koherencë të plotë me politikat evropiane dhe globale, e shpallin si fushë prioritare pajisjen e nxënësve me aftësitë e nevojshme që sigurojnë përmbushjen e tyre si individë, përmbushjen e përgjegjësive sociale dhe përgatitjen për tregun e punës.

Legjislacioni aktual për arsimin parauniversitar mbështet tërësisht zhvillimin e veprimtarive të institucioneve arsimore parauniversitare për orientimin e nxënësve për karrierën dhe angazhimin e aktorëve në këtë proces.

Mbështetur në nenin 3 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive që nxënësit të **aftësohen për jetë dhe për punë** në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore. Neni 22 i këtij ligji përcakton se arsimi bazë synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe **përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës.**

Aktualisht, **kurrikula e bazuar në kompetenca që zbatohet në arsimin parauniversitar është e orientuar drejt së ardhmes dhe kompetencat kyç mbi të cilat ajo është e ndërtuar u mundësojnë nxënësve të zhvillojnë aftësitë e të nxënësve gjatë gjithë jetës, përfshirë aftësitë e menaxhimit të karrierës.** Krahas edukimit për karrierën përmes kurrikulës, shkollat duhet të ofrojnë mundësi dhe përvoja të gjera për informimin, edukimin dhe këshillimin e nxënësve për karrierën.

Ministria e Arsimit dhe Sportit vlerëson se orientimi dhe këshillimi për karrierën i ndihmon nxënësit të identifikojnë dhe të vlerësojnë aftësitë, interesat, prirjet dhe talentet e tyre, i mbështet ata të zhvillojnë potencialin e tyre, të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik dhe krijues, zgjidhjen e problemeve, bashkëpunimin, përdorimin e TIK-ut etj., të njohin botën e punës dhe të përditësohen me ndryshimet e saj për t’i aftësuar të përshtaten dhe të punësohen në tregun e punës të shekullit të 21-të.

Angazhimi i ekipeve të karrierës në shkolla, i punonjësve arsimorë dhe i aktorëve të tjerë të shkollës në procesin e orientimit për karrierën të nxënësve në klasat 6-9 do të mbështesë më tej nxënësit në këtë drejtim.

Udhëzuesi i orientimit për karrierën të nxënësve në arsimin e mesëm të ulët ka për qëllim:

- ◇ të mbështesë shkollat për planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive për orientimin për karrierën me nxënësit e klasave 6-9-të;
- ◇ të ndihmojë dhe të orientojë drejtuesit e shkollave për koordinimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarive të orientimit për karrierën;

- ◇ të orientojë dhe të mbështesë koordinatorin e orientimit për karrierën për koordinimin, zhvillimin dhe monitorimin e veprimtarive të orientimit për karrierën;
- ◇ të mbështesë mësuesit kujdestarë, mësuesit ndihmës, mësuesit e lëndëve/fushave të të nxënit, psikologët shkollorë dhe punonjësit socialë, për planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive për orientimin dhe këshillimin për karrierën me nxënësit në arsimin e mesëm të ulët;
- ◇ të mbështesë forcimin e bashkëpunimit me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore dhe me aktorët e tjerë, si shkolla të mesme profesionale, profesionistë të fushave të ndryshme, pushteti lokal, biznesi etj., për orientimin e nxënësve për karrierën;
- ◇ t'u vijë në ndihmë Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP-ve) dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP-ve) për mbështetjen, koordinimin dhe monitorimin e veprimtarive të institucioneve arsimore.

1. KONCEPTI I ORIENTIMIT PËR KARRIERËN NË KLASAT 6-9

Orientimi për karrierën i nxënësve të klasave 6-9 është një aspekt thelbësor i zhvillimit të tyre arsimor dhe personal. Ai përfshin drejtimin dhe përgatitjen e tyre për zgjedhjet e ardhshme të karrierës, duke i ndihmuar ata të eksplorojnë interesat, aftësitë dhe shtigjet e mundshme të karrierës së tyre.

Orientimi për karrierën i nxënësve të kësaj grup-moshe është një proces gjithëpërfshirës dhe hulumtues që i ndihmon ata të zbulojnë interesat dhe pikat e tyre të forta, duke fituar një kuptim themelor të botës së punës. Ky proces ndërton skemën për një planifikim më të thelluar të karrierës në vitet e mëvonshme të arsimimit dhe karrierës së tyre.

Disa komponentë të orientimit për karrierën në këtë grup-moshë mund të përmbliidhen si më poshtë:

Veteksplorimi: Përfshin inkurajimin e nxënësve që të përfshihen në aktivitete veteksplorimi për të identifikuar interesat, pikat e forta dhe vlerat e tyre.

Ndërgjegjësimi për karrierën: Përfshin prezantimin e nxënësve me një sërë mundësish karriere. Në funksion të këtij procesi mund të takohen profesionistë nga fusha të ndryshme në biseda për karrierën, të organizohen udhëtime në vendet e punës ose të përdoren burime si video dhe libra për të shfaqur profesione dhe karriera të ndryshme.

Eksplorimi akademik: Përfshin orientimin e nxënësve që të kuptojnë lidhjen midis arsimimit të tyre aktual dhe karrierës së mundshme në të ardhmen. Në përmbushje të këtij qëllimi diskutohet me nxënësit se si lëndët dhe aftësitë e tyre mund të jenë të rëndësishme për profesione të ndryshme.

Zhvillimi i aftësive: Mbështetja e zhvillimit të aftësive thelbësore si komunikimi, zgjidhja e problemeve, puna në grup dhe të menduarit kritik është një pjesë e rëndësishme e orientimit për karrierën. Këto aftësi janë të vlefshme në pothuajse çdo drejtim karriere.

Vendosja e qëllimeve: Inkurajimi i nxënësve që të vendosin qëllime afatshkurtra dhe afatgjata në lidhje me arsimimin dhe karrierën e tyre të ardhshme i ndihmon ata të qëndrojnë të motivuar dhe të fokusuar.

Modelet e roleve: Përfshijnë njohjen e nxënësve me modele dhe profesionistë që mund të ofrojnë këshilla të vlefshme dhe frymëzim në lidhje me shtigjet specifike të karrierës.

Hulumtimi për karrierën: Informimi i nxënësve se si të hulumtojnë për karrierën në mënyrë të pavarur përfshin përdorimin e burimeve të ndryshme në internet, leximin e përshkrimeve të punës, kërkesat arsimore etj.

Aftësitë vendimmarrëse: Nxitja e nxënësve që të zhvillojnë aftësitë e vendimmarrjes në mënyrë që ata të mund të bëjnë zgjedhje të informuara për karrierën e tyre të ardhshme, mundësohet përmes diskutimit të faktorëve si stabiliteti i punës, kënaqësia në punë dhe ekuilibri punë-jetë.

Përfshirja e prindërve: Inkurajimi i prindërve që të marrin pjesë në procesin e orientimit për karrierën duke diskutuar rrugëtimet e tyre në karrierë dhe duke mbështetur eksplorimin e fëmijës së tyre.

Fleksibiliteti: Të kuptuarit se zgjedhjet e karrierës mund të evoluojnë me kalimin e kohës, ka si qëllim të ndihmohen nxënësit të marrin vendime të mirinformuara, jo t'i mbyllin ato në një rrugë specifike.

Planifikimi i arsimimit: Përfshin diskutimin e mundësive/alternativave për arsimim pas arsimit bazë, të tilla si shkolla të mesme profesionale, ato me drejtim të orientuar etj., dhe se si ato lidhen me karriera të ndryshme.

Aftësitë e botës reale: Zhvillimi i aftësive praktike për jetën, të tilla si njohuritë financiare, menaxhimi i kohës dhe krijimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimeve, janë thelbësore për suksesin në çdo karrierë.

Drejtimet e karrierës: Prezantimi i konceptit të drejtimeve të karrierës, përfshin të kuptuarit e hapave dhe kualifikimeve të nevojshme për të hyrë në profesione specifike.

2. RËNDËSIA E ORIENTIMIT PËR KARRIERËN TË NXËNËSVE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT (KLASAT 6-9)

Zhvillimi i karrierës është një proces që zgjat gjatë gjithë jetës. Ai fillon në familje, zhvillohet gjatë periudhës së shkollimit si dhe përvojave të punës dhe shfaqet, njehsohet me aftësinë e individit për të marrë vendime për të ardhmen e tij, në përshtatje me statusin e kualifikimit dhe me ndryshimet e tregut të punës.

Orientimi për karrierën i referohet veprimtarive të përcaktuara për të ndihmuar individët e çdo moshe në çdo etapë të jetës së tyre, për të bërë zgjedhjen e tyre sa i takon arsimin, formimit dhe profesionit dhe për të menaxhuar karrierën e tyre.

Orientimi për karrierën i nxënësve në klasat 6-9 ka si qëllim mbështetjen e nxënësve për të kuptuar veten dhe mjedisin në të cilin jetojnë, duke u siguruar mundësi dhe përvoja në mënyrë që ata të pajisen me aftësi dhe kompetenca për të përzgjedhur dhe vendosur për rrugët e arsimimit të tyre të mëtejshëm dhe përgatitjen për tregun e punës.

Nxënësit në arsimin e mesëm të ulët janë në një periudhë të vullshme zhvillimi dhe ndryshimesh. Kjo është një periudhë e rëndësishme për zhvillimin e tyre intelektual, emocional dhe social. Nxënësit formojnë identitetin, mësojnë të jetojnë me më shumë pavarësi dhe të shfaqin interes në eksplorimin e botës rreth tyre. Ata zhvillojnë aftësitë akademike dhe aftësitë e tyre të organizimit, ndërkohë që përballen me më shumë lëndë shkollore dhe me kërkesa më të mëdha mësimore. Kjo mund të jetë sfiduese për ta, por gjithashtu është një mundësi për të mësuar dhe për t'u rritur. Nxënësit formojnë marrëdhënie të reja shoqërore, zhvillojnë aftësi të reja për t'i kuptuar dhe për të kontrolluar emocionet e tyre. Prania e një mjedisi mbështetës në shkollë dhe familje është e rëndësishme për të ndihmuar nxënësit të përballen me këto sfida, në mënyrë që të zhvillojnë vetëbesim dhe qëndrueshmëri për kalimin në stadin tjetër të shkollimit.

Në shumë raste ekziston pavendosmëri e nxënësve rreth profesionit dhe drejtimit/shkollës që duhet zgjedhur; në disa raste informimi i pamjaftueshëm për profilet e shkollave profesionale bën që nxënësit të mos i zgjedhin.

Përmes orientimit dhe këshillimit për karrierën, nxënësit e arsimin të mesëm të ulët mbështeten të zhvillojnë aftësi për të përpunuar shprehjet, cilësitë, dëshirat, mundësitë

personale me prirjet e zhvillimit ekonomik dhe të tregut të punës, si dhe me mundësitë për arsimim, me qëllim planifikimin dhe vendimmarrjen për shkollimin dhe kualifikimin e mëtejshëm.

Përmes orientimit për karrierën mund të tejkalohen diskutimet në familje që lidhen me përfundimin e klasës së 9-të dhe zgjedhjen e shkollimit të mëtejshëm: arsim i mesëm profesional apo gjimnaz, përzgjedhja e drejtimit/profililit të një shkolle profesionale etj.

Orientimi për karrierën, në tërësinë e tij, trajton disa probleme që lidhen jo vetëm me nxënësin, por edhe me familjen e tij, si edhe me mjedisin social ku ai vepron. Përmes këtij procesi lehtësohet edhe çështja e mungesës së vendimmarrjes për të ardhmen, në rast të braktisjes së shkollës.

Fuqizimi i mbështetjes për nxënësit e klasave 6-9 synon ndërtimin e praktikave të qëndrueshme të orientimit për karrierën, duke vendosur nxënësit në qendër, për t'i mbështetur ata në zhvillimin e tyre personal dhe profesional.

Orientimi i nxënësve për karrierën në arsimin e mesëm të ulët ka si qëllim:

1. **Zhvillimin e interesave dhe pikave të forta:** Arsimi i mesëm i ulët është një periudhë vendimtare kur nxënësit zhvillojnë aftësitë, interesat dhe pikat e forta. Orientimi për karrierën i ndihmon ata të identifikojnë pasionet dhe talentet e tyre, duke iu mundësuar të marrin vendime të informuara për rrugët e tyre të ardhshme të karrierës.
2. **Ndërgjegjësimin për mundësitë e karrierës:** Shumë nxënës mund të mos jenë të vetëdijshëm për gamën e gjerë të mundësive të karrierës në dispozicion të tyre. Orientimi për karrierën i ekspozon ata me drejtime të ndryshme karriere, duke ofruar informacion për aftësitë, edukimin dhe trajnimin e kërkuar për profesione të ndryshme. Kjo i ndihmon nxënësit të zgjerojnë njohuritë e tyre dhe i mbështet ata dhe prindërit e tyre të bëjnë zgjedhje më të informuara.
3. **Zhvillimin e aftësive të vendimmarrjes.** Orientimi për karrierën i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e vendimmarrjes duke u mësuar të vlerësojnë aspektet pozitive dhe negative të alternativave të ndryshme, të vlerësojnë interesat dhe aftësitë e tyre dhe të vendosin qëllime realiste. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që nxënësit

të bëjnë zgjedhje që përputhen me aspiratat dhe aftësitë e tyre personale.

4. **Rritjen e performancës në procesin e të nxënësve.** Kur nxënësit kanë një kuptim të qartë të qëllimeve të karrierës dhe rëndësisë së arsimit të tyre, ata motivohen dhe angazhohen më shumë në procesin e tyre të të nxënësve.
5. **Planifikimin e kalimit nga një nivel në tjetrin.** Arsimi i mesëm i ulët është një periudhë tranzicioni drejt arsimit të mesëm të lartë. Orientimi për karrierën i ndihmon nxënësit të përgatiten për këtë tranzicion duke siguruar për ta dhe prindërit e tyre informacion në lidhje me degëzimet e ndryshme të arsimit, zgjedhjen e lëndëve dhe opsionet e mundshme të karrierës që lidhen me to. Kjo siguron që nxënësit të mund të marrin vendime të informuara rreth rrugëve të tyre arsimore dhe të karrierës.
6. **Adresimin e pabarazive sociale.** Orientimi dhe këshillimi për karrierën ndihmon në reduktimin e paragjyqimeve dhe stereotipeve duke u dhënë nxënësve njohuri dhe besim për të ndjekur karriera të cilat mund të mos jenë në përputhje me stereotipet tradicionale gjinore, sociale ose kulturore.

Në këtë kuptim, orientimi i nxënësve për karrierën në arsimin e mesëm të ulët luan një rol vendimtar për t'i ndihmuar nxënësit të zhvillojnë vetëdijen, të marrin vendime të informuara dhe të eksplorojnë në mënyrë efektive në shtigjet e tyre të arsimit dhe të karrierës.

Orientimi i nxënësve për karrierën realizohet përmes fushave të mëposhtme të veprimtarive:

A. Informacioni për karrierën

B. Këshillimi për karrierën

C. Edukimi për karrierën.

Informacioni për karrierën përfshin informacionin rreth institucioneve arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe shtigjeve të karrierës që lidhen me ndjekjen e tyre, rreth lëndëve/fushave të studimit dhe mundësive që ato ofrojnë për punësim dhe avancim në karrierë, rreth kurseve të formimit/trajnitimit, profesioneve dhe drejtimeve të mundshme të karrierës etj. Informacioni për karrierën mund të ofrohet nga koordinatori për orientimin për karrierën, mësuesit kujdestarë, mësuesit e lëndëve/fushave të të nxënësve, punonjësit e shërbimit psiko-social etj. Informacioni për karrierën:

- ✧ duhet të jetë i thjeshtë për t'u kuptuar nga nxënësit;
- ✧ duhet të jetë i saktë dhe i përditësuar;
- ✧ duhet të vijë nga burime të besueshme;
- ✧ jepet në varësi të nevojës/vendimmarrjes që ka nxënësi.

A. Këshillimi për karrierën mund të kryhet në baza individuale ose me fokus grupe, ku vëmendja fokusohet tek problemet apo zgjedhjet specifike në lidhje me karrierën me të cilat ballafaqohen nxënësit. Këshillimi për karrierën kërkon ndërhyrjen e një personi më të specializuar. *Koordinatori i orientimit për karrierën në institucionin arsimor, psikologu shkollor, punonjësi social mund të mbështesin nxënësit me konsultime për aspekte të veçanta të orientimit për karrierën.*

B. Edukimi për karrierën i referohet veprimtarive që zhvillon shkolla për të ndihmuar nxënësit të qartësojnë qëllimet e tyre për karrierë, të kuptojnë botën e punës dhe të mësimin, si dhe të zhvillojnë aftësitë për menaxhimin e karrierës.

Edukimi për karrierën realizohet përmes kurrikulës (njohurive që marrin nxënësit përmes fushave të të nxënës dhe lëndëve që i përbëjnë ato, në lidhje me botën ekonomike, sociale, profesionet etj., aftësive dhe qëndrimeve që zhvillojnë përmes veprimtarive/projekteve kurrikulare etj.), *dhe përmes veprimtarive ekstrakurrikulare.*

Përmes edukimit për karrierën, nxënësit zhvillojnë kompetenca të cilat i shërbejnë çdo individ për menaxhimin e suksesshëm të karrierës së tij gjatë gjithë jetës; ato përfshijnë tri fushat e mëposhtme:

- ✧ Vetëvlerësimi
- ✧ Eksplorimi i mundësive për karrierën
- ✧ Vendimmarrja dhe veprimi për karrierën

Vetëvlerësimi

Nxënësit:

- *Ndërtojnë dhe ruajnë një koncept pozitiv për veten.*
- *Ndërveprojnë në mënyrë efektive dhe pozitive me të tjerët.*
- *Zhvillojnë strategji për t'iu përgjigjur pozitivisht ndryshimeve në jetë dhe në punë.*

Eksplorimi i mundësive për karrierën

Nxënësit:

- *Bëhen pjesë e të nxënit gjatë gjithë jetës për të mbështetur arritjen e qëllimeve në karrierë.*
- *Gjejnë dhe përdorin në mënyrë efektive informacionin e karrierës.*
- *Kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet punës, ekonomisë dhe shoqërisë.*

Vendimmarrja dhe veprimi për karrierën

Nxënësit:

- *Zhvillojnë aftësitë për të marrë vendime për zhvillimin e karrierës.*
- *Eksplorojnë dhe kuptojnë ndërveprimin midis roleve në jetë dhe në punë.*
- *Menaxhojnë procesin e zhvillimit të karrierës.*

Për të tri fushat, kompetencat zhvillohen nga nxënësit në mënyrë graduale përgjatë viteve të shkollimit, përmes veprimtarive kros dhe ekstrakurrikulare për orientimin për karrierën.

3. EDUKIMI PËR KARRIERËN PËRMES KURRIKULËS ME BAZË KOMPETENCAT

Qasja filozofike e kurrikulës bazuar në kompetenca e cila përshkon çdo fushë të nxëni në arsimin bazë, konsideron si fokus të formimit të nxënësve zhvillimin e kompetencave kyçe. Shtatë kompetencat kyçe sipas të cilave organizohet kurrikula e arsimit bazë, synojnë të aftësojnë nxënësit për të nxënit gjatë gjithë jetës. Këto kompetenca, të përfshira përmes rezultateve të të nxënit në programet mësimore të të gjitha lëndëve, zhvillojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime të cilat mundësojnë që fëmijët dhe të rinjtë:

- ✧ të zhvillojnë personalitetin;
- ✧ të nxënë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri;
- ✧ të zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese, aftësi të nevojshme për vendimmarrje të mirëmenduara;
- ✧ të zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes dhe të jenë të motivuar për të përmbushur objektivat;
- ✧ të përdorin TIK-un për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar dhe shkëmbyer informacion,
- ✧ si dhe për të bashkëpunuar në rrjetet informuese në internet;
- ✧ etj.

Në *arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9)*, rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe të përfshira në programet mësimore dhe njohuritë e zhvilluara përmes lëndëve të ndryshme mundësojnë që nxënësit të zhvillojnë aftësi për menaxhimin e karrierës. *Mësuesit e lëndëve/fushave të të nxënit duhet të kenë në vëmendje ndërlidhjen e lëndëve me zbatimet e tyre në jetën e përditshme, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë dhe të shfrytëzojnë mundësitë që ofrojnë këto lëndë për njohjen e profesioneve dhe zhvillimin e karrierave të ardhshme.*

Përgjatë klasave 6-9, në lëndën e **Gjuhës shqipe** nxënësit aftësohen të shkruajnë njoftime të shkurtra, letra formale, një shkrim në gazetë, një jetëshkrim (curriculum vitae), të zhvillojnë një intervistë etj.

Në lëndën e **Gjeografisë** nxënësit mësojnë për profesionin e gjeografit dhe mundësitë që ofron ky profesion për karrierat e ardhshme, sikurse zhvillojnë njohuri për botën ekonomike dhe shoqërore.

Në lëndën e **Qytetarisë** nxënësit zhvillojnë konceptin e njohjes së vetvetes/vetëdijen për aftësitë e tyre, interesat dhe vlerat dhe mësojnë të vendosin qëllime për të ardhmen e tyre. Përmes veprimtarive nxënësit hulumtojnë se si punë të ndryshme sigurojnë të ardhura të ndryshme mujore; eksplorojnë grupimet e profesioneve që lidhen ndërmjet tyre nga aftësitë dhe produktet, identifikojnë punët ose profesionet që do të jenë objekt i eksplorimit të mëtejshëm. Nxënësit mësojnë për faktorët kryesorë që duhet të analizohen dhe të merren parasysh në zgjedhjen e një profesioni ose pune; eksplorojnë më nga afër disa nga fushat e industrisë/të ekonomisë, të cilat parashikohen të kenë më shumë mundësi punësimi dhe, për rrjedhojë, janë parësore për t'u njohur dhe eksploruar më thellë nga nxënësit.

Lënda e Qytetarisë u jep nxënësve mundësinë të njihen në përputhje me nivelin e shkollimit dhe të kurrikulës, me konceptet kryesore ekonomike dhe rëndësinë që ka njohja e tyre për jetën e tyre dhe të shoqërisë. Në këtë mënyrë, mundësohet edhe realizimi i kompetencës ekonomike, që nënkupton njohuri për funksionimin e botës ekonomike dhe aftësi për të vepruar me mençuri në këtë botë.

Përfshirja e nxënësve në aktivitetet **STEAM**¹ zhvillon aftësitë e të menduarit kritik dhe krijues të zgjidhjes së problemeve, nxit inovacionin, kuriozitetin dhe pasionin për shkencat dhe teknologjinë, duke i frymëzuar për eksplorimin dhe ndjekjen e karrierave në këto fusha.

Fusha e **Arteve** zhvillon talentet në këtë fushë dhe i njeh nxënësit me disa nga profesionet që zhvillon kjo fushë, si piktor, skulptor, muzikant, këngëtar etj.

Përmes lëndës së **TIK-ut** nxënësit mësojnë të përdorin TIK-un për të kërkuar informacion për profesionet dhe karrierat, për të kryer detyra që u ngarkohen, për të kryer aplikime dhe për të prezantuar punime dhe produkte të punës së tyre etj.

Pjesë e rëndësishme e edukimit për karrierën janë dhe veprimtaritë që shkollat zhvillojnë brenda procesit mësimor në orët e kujdestarisë si dhe në veprimtaritë e tjera jashtë procesit mësimor.

¹ STEAM është një qasje e integruar që përfshin lëndët e shkencave të natyrës, teknologjinë, inxhinierinë, artet dhe matematikën si një mjet për zhvillimin e kërkimit, komunikimit dhe të menduarit kritik të nxënësve.

4. VEPRIMTARITË PËR ORIENTIMIN PËR KARRIERËN TË NXËNËSVE NË KLASAT 6-9

Veprimtaritë për orientimin për karrierën të nxënësve në klasat 6-9 mund të përfshijnë veprimtari individuale dhe/ose në grup, në nivel klase dhe/ose shkolle, kros dhe ekstrakurrikulare. Këto veprimtari planifikohen të zhvillohen me nxënësit nga mësuesit kujdestarë, nga psikologët shkollorë dhe punonjësit socialë, nga mësuesit e lëndëve të ndryshme, në bashkëpunim me prindërit dhe me organizmat e shkollës (bordi i shkollës, qeveria e nxënësve, këshilli i prindërve), në bashkëpunim me anëtarë të tjerë komunitetit, nën koordinimin e koordinatorit të shkollës për orientimin për karrierën dhe të drejtorisë së institucionit arsimor.

Veprimtaritë për orientimin për karrierën në shkolla synojnë që nxënësit e klasave 6 - 9:

- ❖ *Të zhvillojnë vetëdijen dhe të reflektojnë për interesat, vlerat, aftësitë dhe prirjet e tyre.*
- ❖ *Të jenë të informuar për profesionet, veçoritë e tyre, shtigjet e karrierës dhe mundësitë që ofron tregu i punës në mënyrë që të lidhin këto njohuri rreth asaj se kush janë dhe çfarë mund të bëhen në tregun e punës.*
- ❖ *Të zhvillojnë përvojën dhe lidhjen me arsimimin e mëtejshëm dhe botën e punës përmes aktiviteteve në bashkëpunim me shkollat e arsimit të mesëm profesional, arsimit të mesëm të orientuar, gjimnazet, biznesin, universitetet, pushtetin lokal etj.*
- ❖ *Në mënyrë të veçantë nxënësit e klasave të 9-ta të ndjehen të mbështetur për ta bërë sa më efektiv kalimin në arsimin e mesëm të lartë, bazuar në njohjen e vetes, interesave, shkathtësive e aftësive të tyre, si dhe burimet dhe mundësitë e lidhura me to.*
- ❖ *Këto veprimtari ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve për trekëndëshin: treg pune, aftësi dhe mundësi e nxënësit.*

Veprimtaritë për orientimin për karrierën mbështeten në parimin e Gjithëpërfshirjes

Qëllimi i orientimit për karrierën është aftësimi dhe zhvillimi maksimal i potencialeve të çdo individi. Fokus të veçantë në veprimtaritë për orientimin për karrierën merr mbështetja e nxënësve që i përkasin grupeve vulnerabël, nxënësve me aftësi të kufizuara, nxënësve romë dhe egjiptianë, nxënësve nga shtresa sociale në nevojë, në mënyrë që të identifikojnë dhe të zhvillojnë qëllime karriere që përshtaten me nevojat dhe interesat e tyre individuale.

Në këtë proces orientimi është me shumë rëndësi të përfshihen krahas mësuesve dhe shërbimit psiko-social, edhe mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara, prindërit e tyre, si dhe mediatorët që janë pranë shkollave për të mbështetur arsimimin dhe aftësimin për jetesë të pavarur të nxënësve nga grupet vulnerabël, përfshirë edhe ato romë dhe egjiptianë.

Veprimtaritë për orientimin për karrierën duhet të sigurojnë barazi dhe etikë të qëndrueshme. Ato duhet të vendosin nxënësin në qendër dhe të sigurojnë bashkëveprim dhe rrugë të shumta komunikimi mes nxënësve, ekipeve të karrierës në shkollë dhe prindërve.

Veprimtaritë e përshkruara në vazhdim janë veprimtari sugjeruese, të cilat mund të planifikohen dhe të zbatohen me fleksibilitet nga shkollat, në varësi të veçorive dhe të nevojave të nxënësve, si dhe të kushteve dhe mundësive që ka shkolla.

Shkollat dhe anëtarët e stafeve mësimore mund të zgjedhin të zhvillojnë nga këto veprimtari sikurse të shfrytëzojnë përvojat e suksesshme dhe efektive që kanë krijuar në lidhje me veprimtaritë për orientimin e nxënësve për karrierën.

Veprimtaritë që organizohen gjatë klasave 6, 7, 8 dhe 9-të janë në vijim të njëra-tjetrës duke u zgjeruar më shumë dhe duke gjurmuar zhvillimin e interesave dhe aftësive të nxënësve.

4.1. Veprimtaritë për orientimin për karrierën të nxënësve në klasën e 6-të

Veprimtaritë për orientimin në karrierë në klasën e 6-të janë të rëndësishme për të ndihmuar nxënësit të zbulojnë interesat e tyre dhe të zhvillojnë njohuritë e tyre për profesionet e mundshme në të ardhmen. Orientimi dhe këshillimi për karrierën në këtë moment të shkollimit nuk synon që nxënësit të përzgjedhin drejtimet e karrierës së tyre, por i ndihmon ata të kuptojnë ndërlidhjen e gjithçkaje që bëjnë në jetë në mënyrë që të fillojnë të hedhin hapat e parë drejt një modeli të vendimmarrjes për karrierën e tyre. Veprimtaritë për orientimin në karrierë në klasën e 6-të fokusohen në mbështetjen e nxënësve që të zbulojnë interesat, të mësojnë mbi mundësitë e profesioneve në tregun e punës dhe të ndihmohen në vendimmarrjen e tyre për të ardhmen. Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit mbështet kërkimin e informacionit për karrierën dhe përpunimin e tij.

Disa veprimtari të rekomanduara për orientimin në karrierë për nxënësit e klasave të gjashta mund të përmbliidhen si më poshtë:

- ✧ *Veprimtari për zbulimin e interesave dhe të aftësive:* Këto veprimtari mund të përfshijnë përdorimin e pyetësorëve ose të instrumenteve të tjerë, të cilët mbështesin nxënësit të identifikojnë interesat dhe aftësitë e tyre. Veprimtaria përfshin skicimin e një prezantimi për veten sipas një formati të dhënë nga mësuesi.
- ✧ *Hobet dhe talentet:* Përfshin inkurajimin e nxënësve të eksplorojnë hobet dhe talentet e tyre, pasi këto shpesh mund të çojnë në një karrierë të përmbushur. Për shembull, nëse një nxënës i pëlqen të vizatojë, diskutohet për karrierën në art dhe dizajn.
- ✧ *Libra dhe video të lidhura me karrierën:* Përfshirja e librave dhe videove të përshtatshme për moshën që prezantojnë karriera të ndryshme dhe aftësitë e kërkua për to.
- ✧ *Veprimtari për njohjen e profesioneve:* Diskutohet me nxënësit rreth profesioneve që kanë anëtarët e ndryshëm të familjes ose njerëz të afërt të rrethit familjar dhe shoqëror: për aspektet pozitive, sfidat e lidhura me këto profesione, stereotipet gjinore të lidhura me ushtrimin e profesioneve të caktuara. Nxënësit vetë mund të përgatisin dhe të zhvillojnë prezantime rreth profesioneve të ndryshme dhe të përshkruajnë arsyet pse i

kanë zgjedhur ato. Kjo nxit motivimin dhe i ndihmon nxënësit të përmirësojnë aftësitë e tyre.

- ✧ *Lojë me role*: Organizimi i aktiviteteve me role ku nxënësit marrin rolet e profesionistëve të ndryshëm. Kjo mund t'i ndihmojë ata të kuptojnë se çfarë kërkojnë punë të ndryshme dhe nëse i shohin ato interesante.
- ✧ *Ftesë për prindërit*: Takime dhe biseda me prindër si profesionistë të fushave të ndryshme. Prindër të profesioneve të ndryshme mund të ftohen të tregojnë për punën dhe përvojën e tyre përgjatë karrierës. Kjo ndihmon nxënësit të kuptojnë se çfarë përfshin puna në një profesion të caktuar, duke bërë një parashikim të karrierës në të ardhmen. Bëhet kujdes të inkurajohet pjesëmarrja dhe angazhimi i prindërve të nxënësve të grupeve vulnerabël si: fëmijëve me aftësi të kufizuara, i nxënësve romë dhe egjiptianë dhe grupeve të tjera në nevojë.
- ✧ *Udhëtime/vizita të mbikëqyrura në një kompani ose institucion, biseda me profesionistë*: Planifikimi i udhëtimeve në kompani ose institucione lokale që lidhen me profesione të ndryshme. Shikimi i vendeve reale të punës mund të jetë tërheqës për nxënësit. Nxënësit mund të bëjnë pyetje dhe të mësojnë për profesionet.
- ✧ Etj.

Shënim! Këto veprimtari duhet të planifikohen në përshtatje me moshën e nxënësve dhe të sigurojnë ndërveprim për të angazhuar nxënësit dhe për ta bërë procesin e orientimit në karrierë të këndshëm dhe informues. Qëllimi është që nxënësit të njohin dhe zbulojnë aftësitë, cilësitë, prirjet dhe talentet tyre, dhe të ngjallet kureshtja për profesionet.

4.2. Veprimtaritë për orientimin për karrierën të nxënësve në klasën e 7-të

Veprimtaritë për orientimin për karrierën në klasën e 7-të janë të rëndësishme për të ndihmuar nxënësit të përgatisin veten për të ardhmen dhe të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e vetëvlerësimit, të njohjes së mundësive, të planifikimit dhe vendimmarrjes për karrierën.

Disa nga veprimtaritë e sugjeruara për orientimin për karrierën të nxënësve në klasën e 7-të mund të përmbliken si më poshtë:

- ◇ *Mbledhja e informacionit rreth fushave të interesit (projektet e kërkimit të karrierës):* Nxënësit individualisht kërkojnë dhe mbledhin informacion mbi fushat e tyre të interesit dhe mundësitë e karrierës që lidhen me to. Ata kërkojnë burime në internet, intervistojnë familjarë dhe miq që kanë një karrierë të ngjashme, si dhe mund të vizitojnë vende të punës (së prindërve ose të familjarëve) për të mësuar më shumë rreth fushave të tyre të interesit. Veprimtaria mund të përfshijë prezantimin nga nxënësit të interesave dhe dëshirave personale sipas një formati të caktuar.

Në mënyrë më të zgjeruar, nxënësit mund të punojnë në grupe për të hulumtuar profesionet e ndryshme dhe mundësitë e karrierës që lidhen me to. Ata mund të ndajnë zbulimet e tyre me njëri-tjetrin për të krijuar një udhëzues (album/fletëpalosje) të përbashkët të karrierës.
- ◇ *Lojëra për eksplorimin e karrierës:* Përdorimi i lojërave ndërvepruese ose mjeteve në internet të krijuara për eksplorimin e karrierës, nën drejtimin e mësuesit. Këto lojëra mund ta bëjnë procesin më tërheqës dhe argëtues për nxënësit.
- ◇ *Një ditë në "punë":* Organizimi i nxënësve të kalojnë një ditë ose një pjesë të ditës në një kompani ose institucion me një profesionist në një fushë me interes. Kjo përvojë praktike mund t'u japë një ide më të qartë se çfarë bën një profesionist dhe si është jeta e punës në këtë fushë.
- ◇ *Njohja dhe diskutimi i modeleve të suksesshme të karrierave në fusha të caktuara të jetës ekonomike dhe shoqërore:* Kjo veprimtari përfshin kërkimin rreth biografive të personave profesionalisht të suksesshëm në jetë, leximin në klasë dhe diskutimin rreth tyre.

- ✧ *Profesionistë të ftuar:* Takime/biseda/intervista me profesionistë të fushave të ndryshme të cilët mund të jenë personalitete të shquara nga fusha të ndryshme (shkenca, arti, sporti, fusha të tjera të jetës shoqërore etj.), zejtare, profesionistë të dalë në pension (p.sh., gjyshër, mësues pensionistë etj), modele suksesi të personave me aftësi të kufizuar etj. Këto takime shoqërohen me prezantime të historive të suksesshme për ndikimin e kualifikimit dhe të përvojës profesionale në zhvillimin e karrierës nga të ftuar të ndryshëm. Nxënësit mund të intervistojnë profesionistët që kanë sukses në fushat e tyre për të mësuar më shumë rreth rrugës së tyre drejt suksesit. Ata përgatisin intervista të strukturuar dhe marrin këshilla në lidhje me zgjedhjen e tyre të karrierës.
- ✧ *Përgatitja e një plani personal veprimi (Ditari i karrierës):* Plani personal i veprimit mund të përfshijë pikat e forta dhe të dobëta, fushat për përmirësim, përcaktimin e qëllimeve/objektivave dhe përcaktimin e një plani veprimi. Kjo veprimtari mund të rimerret në klasat e mëvonshme pasi i ndihmon nxënësit të ndjekin progresin në rrugën drejt përmbushjes së planit të zhvillimit. Nxënësit reflektojnë në lidhje me qëllimet/objektivat që kanë përcaktuar më parë (monitorojnë përmbushjen e tyre/progresin). Mbajtja e shënimeve është pjesë e rëndësishme për monitorimin e progresit dhe reflektimin në vazhdimësi.
- ✧ Etj.

Planifikimi i këtyre aktiviteteve realizohet në përshtatje me moshën e nxënësve, nevojat dhe interesat specifike të tyre. Qëllimi është që nxënësi të eksplorojë më shumë për aftësitë dhe prirjet e tij, të nxisë kuriozitetin për profesione të ndryshme.

4.3. Veprimtaritë për orientimin për karrierën të nxënësve në klasën e 8-të

Orientimi për karrierën në klasën e 8-të është një proces i rëndësishëm që ndihmon nxënësit të vendosin hapat e tyre të ardhshëm dhe të përgatiten për tranzicionin në klasën e 9-të. Bashkëpunimi me prindërit, me përfaqësues të institucioneve të arsimit të mesëm të lartë, të shkollave të mesme profesionale dhe atyre me drejtim të orientuar, bashkëpunimi me përfaqësues të tregut të punës, me pushtetin lokal dhe anëtarë të tjerë të komunitetit është aspekt i rëndësishëm i planifikimit dhe zhvillimit të veprimtarive. Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ndihmon nxënësit për kërkimin e informacionit për karrierën dhe përpunimin e prezantimit të tij.

Në vazhdim përshkruhen disa ndër veprimtaritë që ndihmojnë nxënësit e klasës së tetë në këtë proces:

- ✧ *Prezantimi dhe argumentimi nga nxënësit i interesave, prirjeve dhe aftësive personale* sipas një formati të caktuar.
- ✧ *Dita/Ditët e karrierës:* Gjatë këtyre ditëve ftohen në shkollë prindër, përfaqësues të shkollave të arsimit të mesëm profesional, përfaqësues të shkollave të arsimit të mesëm të orientuar, përfaqësues të biznesit etj., të cilët u prezantojnë nxënësve informacion për veten, mundësitë që ofrojnë institucionet e tyre etj.
- ✧ *Hartimi i CV-së (jetëshkrimi):* Hartimi nga nxënësit i një CV-je të thjeshtë ku mund të përfshijnë arritjet e tyre mësimore, aktivitetet jashtëshkollore dhe punën vullnetare.
- ✧ *Aftësitë e intervistës:* Kryerja e intervistave simuluese për t'i ndihmuar nxënësit të praktikojnë aftësitë e tyre të intervistimit. Nxënësit mund të intervistojnë prindërit apo të afërm për punën që kryejnë dhe më pas raportojnë në klasë për gjetjet (vihet theksi në teknikat e intervistimit).
- ✧ *Planifikimi i së ardhmes:* Kjo veprimtari përfshin udhëzimin e nxënësve për përcaktimin e qëllimeve afatshkurtra dhe afatgjata. Diskutimi për zgjedhjet e tyre arsimore në përputhje me aspiratat e tyre të karrierës.

- ✧ *Gazetari reflektues*: Inkurajimi i nxënësve që të shkruajnë “artikuj” ku të reflektojnë mbi aspiratat, interesat dhe përvojat e tyre të karrierës në lidhje me eksplorimin e karrierës.
- ✧ *Arsimi profesional*: Prezantimi i nxënësve me rrugët e ndryshme arsimore, duke përfshirë mundësitë e arsimit profesional, arsimit me drejtim të orientuar etj., diskutimi i lidhjes midis arsimimit dhe karrierës.
- ✧ *Aktivitetet e sipërmarrjes*: Inkurajimi i nxënësve që të eksplorojnë sipërmarrjen duke krijuar një plan të thjeshtë biznesi ose duke marrë pjesë në sfidat e sipërmarrjes.
- ✧ *Panairi i profesioneve*: Nxënësit në bashkëpunim me mësuesit, prindërit, aktorë të tjerë dhe koordinatorin e orientimit për karrierën mbledhin informacion për profesione të ndryshme, të cilin mund ta organizojnë në formën e fletëpalosjeve, posterave, videove dhe ta prezantojnë në formën e një panairi.
- ✧ *Takime me prindër, profesionistë të fushave të ndryshme dhe ish-nxënës të shkollës*. Këto takime mund të shoqërohen me prezantime të historive të suksesshme për ndikimin e kualifikimit dhe të përvojës profesionale në zhvillimin e karrierës nga të ftuar të ndryshëm.
- ✧ *Vizita të mbikëqyrura ose vëzhgime të veprimtarive mësimore në shkolla të mesme të arsimit dhe formimit profesional si dhe vizita të mbikëqyrura në vende pune*.
- ✧ *Ndërtimi i një plani personal veprimi (Ditari i karrierës)*: Plani personal i veprimit mund të përfshijë pikat e forta dhe të dobëta, fushat për përmirësim, përcaktimin e qëllimeve/objektivave p.sh., përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe përcaktimin e një plani veprimi. Kjo veprimtari mund të rimerret nga njëra klasë në tjetrën pasi i ndihmon nxënësit të ndjekin progresin në rrugën drejt përbushjes së objektivave, duke reflektuar dhe rishikuar progresin e tij. Mbajtja e shënimeve (p.sh., në formën e një ditari) dhe përdorimi i tyre në vazhdimësi është pjesë e rëndësishme për monitorimin e progresit dhe reflektimin.
- ✧ Etj.

Përshtatja e këtyre veprimtarive me moshën, nevojat dhe interesat specifike të nxënësve është shumë e rëndësishme. Qëllimi është të ndihmohen nxënësit të eksplorojnë dhe kuptojnë më mirë profesionet, si dhe aftësitë që lidhen me to.

4.4. Veprimtaritë për orientimin për karrierën të nxënësve në klasën e 9-të

Veprimtaritë e sugjeruara të orientimit për karrierën në klasën e 9-të synojnë të mbështesin nxënësit të identifikojnë aftësitë, cilësitë, interesat e tyre, të hulumtojnë në tregun e punësimit, arsimimit dhe trajnimit të mëtejshëm, me qëllim planifikimin për karrierën. Përmes tyre, nxënësit zhvillojnë aftësitë e komunikimit dhe mendimin kritik, zhvillojnë aftësitë kërkuese për shkollim, trajnim dhe punë, si dhe planifikojnë/marrin vendim për shkollimin dhe kualifikimin e mëtejshëm.

Njohja dhe eksplorimi i përvojave dhe mundësive për arsimimin e mëtejshëm përmes takimeve, vizitave/vëzhgimeve në shkollat e mesme profesionale apo në institucionet e tjera arsimore të arsimit të mesëm të lartë, sikurse lidhja me botën e punës dhe profesionet merr një rëndësi të veçantë në këtë fazë të përfundimit të arsimit bazë dhe të kalimit në një nivel tjetër.

Koordinatorët e orientimit për karrierën në shkolla dhe drejtuesit e institucioneve arsimore, koordinatorët e orientimit për karrierën të ZVAP-ve dhe të DRAP-ve, kanë një rol të rëndësishëm për të siguruar bashkëpunimin me këto institucione arsimore dhe përfaqësues të botës së punës, si dhe bashkërendimin e veprimtarive të përbashkëta në mbështetje të nxënësve në klasën e 9-të.

Disa nga veprimtaritë e sugjeruara për orientimin për karrierën të nxënësve në klasën e 9-të përfshijnë:

- ◇ *Analiza SWOT*: për identifikimin e pikave të forta të nxënësve, pikave të dobëta, mundësive për përmirësim në lidhje me kërkesat e profesionit të tyre të preferuar që synojnë ta kenë në të ardhmen.
- ◇ *Dita/Ditët e karrierës*: Në këto ditë mund të ftohen në shkollë prindër, përfaqësues të shkollave të arsimit të mesëm profesional, përfaqësues të shkollave të arsimit të mesëm të orientuar, përfaqësues të gjimnazeve, përfaqësues të biznesit etj., të cilët u prezantojnë nxënësve informacion për veten, mundësitë që ofrojnë institucionet e tyre etj.
- ◇ *Sfidat e sipërmarrjes*: Organizimi i sfidave, konkurseve ose panairove të sipërmarrjes ku nxënësit mund të zhvillojnë dhe prezantojnë ide biznesi.

- ✧ *Vizita të mbikëqyrura në shkolla të mesme profesionale:* Planifikimi i vizitave në shkolla të mesme profesionale për t'i ndihmuar nxënësit të kuptojnë procesin e aplikimit, mundësitë e ndihmës financiare (bursat), konviktet dhe kërkesat e shkollës. Vëzhgimet e drejtpërdrejta mund të kombinohen me takime virtuale online.
- ✧ *Vizita të mbikëqyrura në shkolla të arsimit të mesëm të orientuar:* Është e rëndësishme që vizitat në këto shkolla t'u japin mundësi nxënësve të njohin nga afër përvojat mësimore. Vëzhgimet e drejtpërdrejta mund të kombinohen me takimet virtuale online.
- ✧ *Vizita të mbikëqyrura në gjimnaze:* Nxënësit njohin nga afër mjediset, mund të ndjekin orë të veçanta dhe bisedojnë me nxënës dhe mësues. Gjithashtu vëzhgimet e drejtpërdrejta mund të kombinohen me takimet virtuale online.
- ✧ *Vizita të mbikëqyrura në kompani të ndryshme* për të parë konkretisht se si punohet në ushtrimin e profesioneve, duke iu krijuar mundësi nxënësve të bisedojnë me punonjës që punojnë në punë për të cilat ata shfaqin interes.
- ✧ *Panelet e karrierës me profesionistë:* Organizimi i diskutimeve në panel me profesionistë nga sektorë të ndryshëm. Nxënësit mund të bëjnë pyetje dhe të fitojnë një kuptim më të gjerë të mundësive të karrierës.
- ✧ *Biseda me prindër:* Prindërit ftohen në takime të rregullta me fëmijët e tyre dhe diskutojnë rreth kurrikulës dhe lëndëve me zgjedhje, rreth planeve të së ardhmes dhe hapave që fëmija duhet të ndër marrë për të arritur objektivat e caktuara. Përveç kësaj, prindërit mund të ftohen për të prezantuar profesionin e tyre, përvojat dhe sfidat e tyre në zhvillimin e karrierës.
- ✧ *Intervista me mësues dhe me instruktorë* të qendrave të arsimit dhe formimit profesional.
- ✧ *Takime dhe biseda* të organizuara me ish- nxënës të shkollës.
- ✧ *Ndërtimi i një plani personal veprimi (Ditari i karrierës):* Plani personal i veprimit mund të përfshijë pikat e forta dhe të dobëta, fushat për përmirësim, përcaktimin e qëllimeve/objektivave p.sh., përzgjedhja e një shkolle të mesme profesionale si mundësi shkollimi dhe përcaktimi i një plani veprimi. Mbajtja e shënimeve (p.sh., në formën e një ditari) dhe përdorimi i tyre në vazhdimësi është pjesë e rëndësishme për monitorimin e progresit dhe reflektimin.
- ✧ *Diskutim mbi ndarjen gjinore të punës dhe anti diskriminimin.*

- ✧ *Angazhimi në komunitet:* Inkurajimi i nxënësve të marrin pjesë në shërbime komunitare ose mundësi vullnetare që lidhen me interesat e tyre, të cilat mund të ofrojnë aftësi dhe lidhje të vlefshme.
- ✧ *Gazetari reflektues:* Nxitja e nxënësve që të shkruajnë ditare dhe artikuj reflektues ku dokumentojnë udhëtimin e tyre të eksplorimit të karrierës që nga klasa 6-të deri në klasë të 9 –të , qëllimet dhe njohuritë e fituara.
- ✧ *Klubet e ndryshme* që i ndihmojnë nxënësit për njohjen e profesioneve, zhvillimin e aftësive që lidhen me ushtrimin e këtyre profesioneve, si dhe të aftësive dhe qëndrimeve të tjera si: iniciativës, aftësive sipërmarrëse, aftësive të bashkëpunimit etj. Klube të tilla mund të jenë klubi i zejtarisë/artizanatit, klubi i kopshtarisë, klubi i kodimit, klubi i gazetës etj. Këto klube mund të menaxhohen nga mësues që i afrohen profilit dhe veprimtaritë mund të realizohen në bashkëpunim me prindër dhe aktorë të tjerë të komunitetit si zejtarë, agro-aktivitete, kompani etj. Po kështu, Klubi i karrierës mund të përfshijë nxënës të klasave të ndryshme të cilët në drejtimin e koordinatorit të karrierës angazhohen për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme të orientimit për karrierën në shkollë.
- ✧ Etj.

Këndi/Qendra burimore e karrierës

Një nga mënyrat e fuqizimit të orientimit dhe këshillimit për karrierën në shkollë është ngritja e një Këndi/Qendre burimore karriere për aktivitetet dhe produktet që kanë të bëjnë me karrierën. Në varësi të mundësive që ka shkolla, Këndi/Qendra e karrierës mund të përfshijë një hapësirë fizike e cila të ofrojë një mjedis mësimor tërheqës të pasur me burime (në formë fizike ose elektronike), postera dhe tabela njoftimesh, ku shënohen mesazhet kryesore të lidhura me orientimin për karrierën, fletëpalosje për t'i inkurajuar nxënësit të kryejnë kërkim vetjak rreth alternativave për të ardhmen dhe mënyra që nxisin diskutimin me prindërit; disponueshmëri burimesh në formate alternative për nxënësit me aftësi të kufizuara, me vështirësi në të nxënë etj.

5. PARIME ETIKE TË ORIENTIMIT PËR KARRIERË

Qasja gjithëpërfshirëse

Koordinatorët e orientimit për karrierën, mësuesit, psikologët shkollorë, punonjësit socialë etj., duhet të marrin parasysh kontekstin e plotë personal, shoqëror, kulturor dhe ekonomik të nxënësit.

Pavarësia e nxënësit

Koordinatorët e orientimit për karrierën, mësuesit, punonjësit arsimorë, psikologët shkollorë dhe punonjësit socialë, respektojnë zhvillimin personal të nxënësit dhe lirinë e zgjedhjes së karrierës. Koordinatorët, mësuesit etj., nuk duhet t'i imponojnë nxënësve pikëpamjet e tyre për zgjedhjen e karrierës dhe nuk duhet të drejtohen nga “vendimmarrja” në emër të nxënësit ose prindërve të tij/saj.

Paanësia

Orientimi për karrierën duhet të jetë në përshtatje me interesat e nxënësit. Koordinatorët e orientimit për karrierën, mësuesit, psikologët shkollorë dhe punonjësit socialë etj., nuk duhet të diskriminojnë nxënësit në bazë të gjinisë, moshës, kombësisë, aftësisë etj.

Konfidencialiteti

Gjatë procesit të orientimit dhe këshillimit për karrierën, duhet të mbrohet privatësia e informacioneve personale të nxënësve.

Cilësia

Koordinatorët e orientimit për karrierën, mësuesit, psikologët shkollorë dhe punonjësit socialë etj., sigurojnë që informacioni i përdorur në edukimin dhe orientimin për karrierë është i saktë dhe i përditësuar. Instrumentet dhe teknikat e tjera të përdorura duhet të jenë të përshtatshme për moshën dhe nevojat e nxënësve.

6. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

6.1. ROLI I INSTITUCIONIT ARSIMOR

6.1.1. ROLI I DREJTORISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR

Roli i drejtorisë të institucionit arsimor është thelbësor për planifikimin dhe zhvillimin në mënyrë efektive të veprimtarive për orientimin për karrierën.

Drejtoria e institucionit arsimor:

- ✧ Është përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e veprimtarive për orientimin për karrierën.
- ✧ Cakton koordinatorin e orientimit për karrierën të institucionit arsimor dhe raporton në ZVAP-në përkatëse. **Koordinatori i institucionit arsimor për orientimin për karrierën mund të jetë një nga drejtuesit e institucionit arsimor, ose mësuesi koordinator i qeverisë së nxënësve, ose mësuesi që merret me veprimtaritë në shkollë.**
- ✧ Bashkëpunon me koordinatorin e orientimit për karrierën në shkollë, mësuesit, punonjësit e shërbimit psiko-social, prindërit dhe anëtarë të tjerë të komunitetit, për të mbështetur orientimin e nxënësve për karrierën.
- ✧ Miraton planin vjetor të veprimtarive për orientimin për karrierën të nxënësve në klasat 6 - 9, të propozuar nga koordinatori i shkollës për orientimin për karrierën në bashkëpunim me mësuesin kujdestar, mësuesin ndihmës, psikologun shkollor dhe punonjësit socialë, dhe e dorëzon në ZVAP për miratim.
- ✧ Kujdeset për sigurimin dhe organizimin e mjediseve/hapësirave, në të cilat do të zhvillohen veprimtaritë për orientimin për karrierën në bashkëpunim me koordinatorin e orientimit për karrierën, mësuesit e angazhuar, qeverinë e nxënësve, bordin e shkollës, përfaqësues të këshillave të prindërve, profesionistë, anëtarë të tjerë të komunitetit.

- ✧ Merr masa të krijojë në institucionin arsimor dhe të përditësojë në bashkëpunim me koordinatorin e orientimit për karrierën, *Këndin e Orientimit për karrierën*, në të cilin përfshihen plani i veprimtarive, shembuj veprimtarish të realizuara me nxënësit dhe bashkëpunimin me anëtarët e komunitetit në kuadër të këtij programi, materiale informuese (fletëpalosje, postera etj.), që sigurojnë informacion për aspekte të ndryshme të orientimit për karrierën.
- ✧ Monitoron zhvillimin dhe progresin e veprimtarive të planifikuara të institucionit arsimor për orientimin për karrierën dhe raporton çdo 3 muaj në ZVAP-në përkatëse.
- ✧ Mbështet dhe inkurajon, së bashku me koordinatorin e shkollës për orientimin për karrierën, bashkëpunimin mes shkollës dhe komunitetit me qëllim lehtësimin e mundësive për të nxënësit për karrierën, nëpërmjet përvojave profesionale në komunitet shumë të nevojshme për zhvillimin e edukimit dhe orientimit për karrierën, organizimin e panairëve të karrierës etj.
- ✧ Analizon realizimin e planit të veprimtarive, raportet e ecurisë së procesit dhe merr masa për zgjidhjen e problemeve.
- ✧ Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me strukturat dhe organizmat në shkollë, këshillin e mësuesve, qeverinë e nxënësve, bordin e shkollës, përfaqësues të këshillave të prindërve, ZVA-në përkatëse.
- ✧ Publikon në faqen web të institucionit arsimor dhe në media sociale informacion të përditësuar për veprimtaritë e orientimit për karrierën të institucionit arsimor.
- ✧ Mbështet zhvillimin profesional të stafit mësimor për orientimin për karrierën.

6.1.2. ROLI I KOORDINATORIT TË ORIENTIMIT PËR KARRIERËN NË

INSTITUCIONIN ARSIMOR

Koordinatori i orientimit për karrierën në institucionin arsimor:

- ✧ Koordinon planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive për orientimin për karrierën në bashkëpunim me drejtuesit e institucionit arsimor, mësuesit kujdestarë, mësuesit e lëndëve/fushave të të nxënësit, punonjësit e shërbimit psiko-social, prindërit, pushtetin lokal dhe anëtarë të tjerë të komunitetit.

- ✧ Mbështet dhe këshillon mësuesit kujdestarë të klasave 6-ta, të 7-ta, të 8-ta dhe të 9-ta për planifikimin e temave/veprimtarive të orientimit për karrierën në planet vjetore të orëve të kujdestarisë të klasave përkatëse dhe koordinon përfshirjen e tyre në planin vjetor të veprimtarive të institucionit arsimor për orientimin për karrierën.
- ✧ Siguron një klimë bashkëpunimi dhe miqësore për zhvillimin e veprimtarive të orientimit për karrierën.
- ✧ Komunikon me nxënësit dhe bashkëpunon me drejtuesit, mësuesit, psikologun shkollor, punonjësin social, prindërit etj., për identifikimin e nevojave të nxënësve në lidhje me orientimin për karrierën dhe për adresimin e tyre. Në shkollat ku është emëruar mediatori për grupet vulnerabël, koordinatori duhet të bashkëpunojë ngushtë me mediatorin për zhvillimin e veprimtarive të orientimit për karrierën.
- ✧ Siguron në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, informacion në lidhje me llojet e shkollave të arsimit të mesëm të lartë etj., dhe e vendos në dispozicion të nxënësve, të prindërve, të mësuesve etj.
- ✧ Zhvillon bashkëbisedime me fokus grupe nxënësish për çështje të caktuara të orientimit për karrierën si p.sh., vlerësimi i interesave dhe nevojave, etj. në bashkëpunim dhe me psikologun shkollor, punonjësin social dhe prindërit.
- ✧ Bashkëpunon me ekipet lëndore për të mbështetur dhe këshilluar mësuesit që të zhvillojnë elementë të edukimit për karrierën përmes lëndëve/fushave të të nxënët (p.sh., në lëndën e gjuhës shqipe nxënësit mësojnë të shkruajnë një CV ose një letër motivimi; në lëndën e teatrit të zhvillojnë një intervistë përmes lojës me role; në lëndën e TIK-ut të gjejnë informacion për institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë; ose në lëndë të ndryshme mund të zhvillojnë një projekt kurrikular për zbatimet e lëndës në jetën e përditshme dhe profesionet që lidhen me të, konkurse të ndryshme etj.).
- ✧ Bashkëpunon me punonjësit e shërbimit psiko-social të institucionit arsimor për zhvillimin e bisedave/takimeve/veprimtarive për orientimin e karrierës me nxënësit (individualisht dhe/ose me fokus grupe), në bashkëpunim me prindërit, duke pasur në vëmendje sigurimin e mbështetjes për nxënësit në rrezik braktisjeje, nxënësit me aftësi të kufizuara etj.
- ✧ Bashkëpunon me mësuesit ndihmës të nxënësve me AK për orientimin e tyre për karrierën, duke mbajtur të informuar edhe prindërit.

- ✧ Në bashkëpunim me drejtues të institucionit arsimor, me mësuesit kujdestarë dhe me anëtarë të tjerë të stafit mësimor koordinon dhe zhvillon takime me prindër; takime me profesionistë të fushave të ndryshme; vizita të nxënësve në shkolla të arsimit të mesëm profesional dhe të arsimit të mesëm të orientuar; vizita në vende pune dhe sipërmarrje të ndryshme; veprimtari si p.sh., Dita/Ditët e karrierës, panairi i karrierës etj.
- ✧ Harton planin vjetor të veprimtarive të institucionit arsimor për orientimin për karrierën, për veprimtaritë e planifikuara në bashkëpunim me mësuesit kujdestarë të klasave 6 - 9, mësuesit e tjerë të angazhuar, punonjësit e shërbimit psiko-social, prindërit, pushtetin lokal dhe anëtarë të tjerë të komunitetit.
- ✧ Përcakton qëllimin e veprimtarisë, nën veprimtaritë që do të realizohen në kuadër të çdo veprimtarie, kohëzgjatjen, personi/at përgjegjës, mjedisin/hapësirën ku do të zhvillohet dhe ia paraqet për miratim drejtorit të institucionit arsimor. Në rast nevojë për ndryshim të këtij plani, merret miratimi nga drejtuesi i institucionit arsimor dhe nga ZVAP.
- ✧ Monitoron ecurinë e zbatimit të veprimtarive për orientimin për karrierën.
- ✧ Përgatit raportin 3-mujor të ecurisë së zbatimit të veprimtarive për orientimin për karrierën dhe ia dërgon drejtorisë së institucionit arsimor.
- ✧ Mbështet mësuesin kujdestar në plotësimin e “Formularit të aftësive dhe prirjeve të nxënësit”.
- ✧ Monitoron daljen (tranzicionin) e nxënësve nga klasa e 9-të dhe mbledh informacion për drejtimin që ndjekin nxënësit që mbarojnë klasën e 9-të.
- ✧ Krijon databazën me të dhënat e mbledhura nga gjurmimi për nxënësit që mbarojnë klasën e 9-të dhe ia dërgon drejtorisë së institucionit arsimor, e cila e dorëzon atë në ZVAP në muajin tetor të vitit shkollor pasardhës, pasi ka mbaruar klasa e nëntë.
- ✧ Merr pjesë në takimet e koordinatorëve të institucioneve arsimore për orientimin për karrierën, të organizuara nga ZVAP, DRAP, DPAP.
- ✧ Angazhohet për zhvillimin e tij profesional dhe merr pjesë në programe/trajnime/shkëmbime përvojash për çështje të ndryshme të edukimit dhe këshillimit për karrierën.

6.1.3. ROLI I PUNONJËSVE ARSIMORË, PSIKOLOGUT SHKOLLOR,

PUNONJËSIT SOCIAL, NXËNËSVE

MËSUESI KUJDESTAR

- ✧ Mësuesi kujdestar është mësuesi që njeh më nga afër nxënësit në lidhje me interesat, nevojat, shqetësimet, arritjet e tyre, kontekstin familjar dhe social. Ai është në kontakt më të shpeshtë dhe më të afërt me prindërit dhe me komunitetin.
- ✧ Në lidhje me veprimtaritë e orientimit për karrierën çdo mësues kujdestar i klasave 6 - 9 përfshin në planin vjetor të orëve të kujdestarisë tema/veprimtari me nxënësit që mbështesin edukimin dhe orientimin për karrierën, duke përzgjedhur nga veprimtaritë e përcaktuara sipas klasave dhe duke i përshtatur me moshën e nxënësve, interesat e tyre dhe mundësitë e shkollës.
- ✧ Mësuesi kujdestar bashkëpunon ngushtësisht me koordinatorin e orientimit për karrierën, mësuesit e lëndëve, psikologun shkollor, punonjësin social, mësuesit ndihmës, prindërit, drejtuesit e institucionit arsimor për identifikimin e nevojave të nxënësve për orientimin për karrierën dhe për realizimin e veprimtarive mbështetëse, në grup ose individualisht.
- ✧ Në përfundim të vitit shkollor, mësuesi kujdestar plotëson “Formularin e aftësive dhe prirjeve të nxënësit” duke vendosur shenjën (✓) në aftësitë, prirjet dhe talentet që janë pika të forta për nxënësin. (Shtojca 1 - Klasa 6; Shtojca 2 - Klasa 7; Shtojca 3 - Klasa 8).
- ✧ Në përfundim të klasës së 9-të, mësuesi kujdestar plotëson formularin përfundimtar “Formular i orientimit të nxënësit për arsimin e mesëm të lartë” (Shtojca 4). Në këtë formular mësuesi sugjeron/orienton nxënësit dhe prindërit për llojin e arsimit të mesëm të lartë që mund të ndjekë nxënësi pas përfundimit të klasës së 9-të, (gjimnaz, arsim i mesëm i orientuar, arsim i mesëm profesional). Ai përzgjedh duke vendosur shenjën (✓) në drejtimin përkatës, bazuar në rezultatet mësimore dhe në aftësitë, prirjet dhe interesat e nxënësit të evidentuara në klasat 6,7,8 dhe në suplementin e klasës 9-të të plotësuar nga mësuesi. Në suplement, mësuesi vendos shenjën (✓) në aftësitë, prirjet dhe talentet që janë pika të forta për nxënësin.

MËSUESIT E LËNDËVE/FUSHAVE TË TË NXËNIT

Mësuesit e lëndëve/fushave të të nxënit:

- ✧ Njohin mundësitë që ofrojnë lëndët/fushat e të nxënit dhe programet mësimore për njohjen e botës së punës, njohjen e profesioneve etj.; për zhvillimin e kompetencave kyçe, të aftësive sipërmarrëse dhe të aftësive të tjera të zhvillimit të karrierës; sigurojnë zhvillimin e tyre përmes strategjive të përshtatshme dhe metodologjive të mësimdhënies si p.sh., puna në grup, projekti, situatat e rastit etj., si dhe të formave të përshtatshme të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.
- ✧ Sigurojnë lidhje efektive ndërmjet fushës së të nxënit/lëndës, edukimit për karrierë dhe shtigjeve të karrierës që nxënësit mund të ndjekin në shkollë dhe pas mbarimit të saj.
- ✧ Angazhohen në diskutime me nxënësit dhe prindërit e tyre rreth procesit të të nxënit, rreth potencialeve dhe mundësive të nxënësve për të ndjekur shtigje të ndryshme karriere.
- ✧ Komunikojnë dhe bashkëpunojnë me koordinatorët e orientimit për karrierën, mësuesit kujdestarë, mësuesit ndihmës, psikologun shkollor, punonjësin social, për nxënësit që mund të kenë nevojë për orientim për karrierë.

MËSUESI NDIHMËS

Mësuesit ndihmës luajnë një rol vendimtar për të ndihmuar nxënësit me aftësi të kufizuara të eksplorojnë mundësitë e karrierës, të zhvillojnë aftësitë e nevojshme dhe të kapërcejnë barrierat për të arritur qëllimet e tyre profesionale. Ata punojnë ngushtë me nxënësit me aftësi të kufizuara sikurse me prindërit duke kuptuar nevojat, pikat e forta dhe sfidat e tyre unike. Ata mund të ofrojnë udhëzime dhe mbështetje të personalizuar, të përshtatur për aspiratat dhe aftësitë e secilit nxënës drejt karrierës.

Mësuesit ndihmës mund të ndihmojnë në vlerësimin e interesave, aftësive dhe prirjeve të nxënësve për t'i ndihmuar ata të identifikojnë opsionet e përshtatshme të karrierës. Ata mund të bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë, si psikologu shkollor, punonjësi social, mësues të arsimit special, këshilltarë dhe terapistë profesionistë, për të vendosur qëllime të arritshme në karrierë. Ata gjithashtu, mund t'i ndihmojnë nxënësit të fitojnë dhe zhvillojnë aftësitë e nevojshme profesionale, si në klasë ashtu edhe nëpërmjet përvojave praktike.

PSIKOLOGËT SHKOLLORË, PUNONJËSIT SOCIALË

Psikologët shkollorë dhe punonjësit socialë janë anëtarë të stafëve të shkollave, të cilët kombinojnë punën e tyre me mësuesit kujdestarë, prindërit, koordinatorin e orientimit për karrierën, drejtuesit e shkollave për adresimin e nevojave emocionale, arsimore dhe sociale të nxënësve.

Punonjësit e shërbimit psiko-social u vijnë në ndihmë nxënësve për njohjen e aftësive, interesave, sfidave dhe vështirësive, duke luajtur një rol të rëndësishëm dhe në parandalimin e braktisjes së shkollës.

Psikologët shkollorë dhe punonjësit socialë mbështesin nxënësit të përmirësojnë marrëdhëniet ndërpersonale, të zhvillojnë vetëvlerësimin, vetëkontrollin, të zhvillojnë aftësi të zgjidhjes së problemeve dhe aftësi vendimmarrëse, si elementë të rëndësishëm të aftësive për jetën dhe të menaxhimit të karrierës së një individi.

Punonjësit e shërbimit psiko-social planifikojnë në planin e tyre zhvillimin e veprimtarive për orientimin për karrierën të nxënësve, të tilla si: biseda, konsultime, aktivitete psiko-sociale, takime me prindër, seanca ndërgjegjësuese, seanca psiko-edukative etj., duke siguruar bashkëpunimin me prindërit, koordinatorin e orientimit për karrierën, drejtorinë e shkollës dhe mësuesit.

MEDIATORËT

Në ato shkolla ku janë caktuar mediatorët, ato duhen të përfshihen në të gjitha veprimtaritë që zhvillohen në shkollë për orientimin për karrierën të grupeve vulnerabël.

NXËNËSIT

Shkollat mund të inkurajojnë përfshirjen e nxënësve dhe mbështetjen e bashkëmoshatarëve për orientimin për karrierën, për shembull nëpërmjet:

- ✧ trajnimit të nxënësve të klasës për programet e mentorimit të bashkëmoshatarëve;
- ✧ përfshirjes dhe angazhimit të nxënësve për krijimin dhe përditësimin e këndit të karrierës;
- ✧ ftesës së ish-nxënësve të shkollës për të ndarë përvojat e arsimimit të mëtejshëm, të trajnimit dhe të punësimit;
- ✧ etj.

6.2. BASHKËPUNIMI ME PRINDËRIT DHE AKTORËT E TJERË

Veprimtaritë e orientimit për karrierën kërkojnë bashkëpunimin dhe angazhimin e partnerëve dhe aktorëve të tjerë, brenda dhe jashtë shkollës.

PRINDËRIT

Shkolla ka detyrë thelbësore ndërgjegjësimit e prindërve duke u kërkuar atyre partneritet për ecurinë e fëmijëve të tyre. Studimet tregojnë se nxënësit performojnë më mirë nëse prindërit e tyre janë përfshirë në arsimimin e tyre. Në mënyrë të veçantë për nxënësit e klasës së 9-të, duke u familjarizuar me veprimtaritë e orientimit për karrierën, prindërit mund të kuptojnë më mirë se si mund të mbështetin fëmijët e tyre në përzgjedhjen e drejtimit/profilin të shkollës së mesme që do të vazhdojnë të ndjekin dhe se si ata mund t'u vijnë në ndihmë në këtë proces. Nxënësit kanë nevojë për këshillat dhe mbështetjen e prindërve ndërkohë që planifikojnë kalimin e tyre në një tjetër shteg karriere.

Gjithashtu, prindërit mund të kontribuojnë në veprimtaritë e shkollës për orientimin për karrierën duke ofruar modelin e një personi të rritur/profesionisti që menaxhon karrierën e tij. Ata mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre në eksplorimin e mundësive më të përshtatshme për zhvillimin e karrierës, përmes një përfshirje më të madhe në veprimtaritë e institucionit arsimor për orientimin për karrierën.

Disa ndër veprimtaritë me prindër mund të përfshijnë takimet e prindërve me mësuesit kujdestarë, me mësuesit e lëndëve, me koordinatorin e orientimit për karrierën, me psikologun shkollor ose punonjësin social, për të diskutuar rreth nevojave individuale të fëmijës për orientimin për karrierën ose takime/ftesa të prindërve në shkollë për të prezantuar përvojat e tyre në lidhje me profesionin dhe karrierën etj.

PËRFAQËSUES TË TJERË TË KOMUNITETIT

Zhvillimi i veprimtarive dhe ofrimi i shërbimeve të orientimit për karrierën në shkolla kërkon zhvillimin e partneriteteve dhe bashkëpunimin me aktorë të tjerë. Ndërmjet tyre mund të përmendim:

- ✧ Institucione arsimore të arsimit të mesëm të lartë, si shkolla të arsimit të mesëm profesional, shkolla të arsimit të mesëm të orientuar etj.
- ✧ Përfaqësues të pushtetit lokal dhe të shërbimeve që ofrojnë.
- ✧ Përfaqësues të botës së punës.
- ✧ Sipërmarrje/biznese/kompani.
- ✧ Etj.

7. ROLI I ZVAP-ve, DRAP-ve, DPAP-së, ASCAP-it

7.1. ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ZVAP)

- ◇ Mbështet dhe këshillon institucionet arsimore për çështje të ndryshme që lidhen me orientimin për karrierën.
- ◇ Miraton planet vjetore të institucioneve arsimore për veprimtaritë e orientimit për karrierën.
- ◇ Monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e realizimit të veprimtarive për orientimin për karrierën në institucionet arsimore dhe raporton çdo 3 muaj në DRAP-in përkatës.
- ◇ Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me DRAP-in dhe DPAP-në për nevojat që lidhen me orientimin për karrierën.
- ◇ Cakton një koordinator në nivel ZVAP-je për orientimin për karrierën, i cili koordinon punën me të gjithë koordinatorët e institucioneve arsimore.
- ◇ Komunikon me koordinatorët e institucioneve arsimore për ecurinë e punës për edukimin dhe këshillimin për karrierën, si dhe për shkëmbimin e përvojave ndërmjet institucioneve arsimore.
- ◇ Grumbullon (koordinatori i ZVAP për orientimin për karrierën), raportet 3-mujore të institucioneve arsimore dhe përgatit raportin përmbledhës të ecurisë së veprimtarive për orientimin për karrierën, për periudhën përkatëse, të cilin e dorëzon në DRAP.
- ◇ Lehtëson lidhjet me komunitetin, me institucione arsimore të arsimit të mesëm të lartë, pushtetin lokal, individë, sipërmarrje etj., për të mbështetur shkollat për zhvillimin e veprimtarive për orientimin për karrierën.

7.2. DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

(DRAP)

- ◇ Mbështet dhe këshillon ZVAP-në përkatëse për çështje të ndryshme që lidhen me zbatimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarive për orientimin për karrierën.
- ◇ Monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e veprimtarive për orientimin për karrierën në ZVAP-të përkatëse dhe institucionet arsimore ku zhvillohen.
- ◇ Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me DPAP-në, ASCAP-in dhe MAS-in, për nevojat që lidhen me edukimin dhe këshillimin për karrierën.
- ◇ Cakton një koordinator në nivel DRAP-i për orientimin për karrierën.
- ◇ Mbështet koordinatorët e ZVAP-ve dhe të institucioneve arsimore, të angazhuar për orientimin për karrierën.
- ◇ Grumbullon (koordinatori i DRAP-it për orientimin për karrierën), raportet 3-mujore të ZVAP-ve nën juridiksionin e saj dhe përgatit raportin përmbledhës të periudhës përkatëse, të cilin e dorëzon në DPAP.

7.3. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT

PARAUNIVERSITAR (DPAP)

- ◇ Mbështet dhe këshillon në nivel kombëtar DRAP-et, ZVAP-të përkatëse për çështje të ndryshme që lidhen me orientimin për karrierën.
- ◇ Monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e veprimtarive të orientimit për karrierën, në të gjitha DRAP-et, ZVAP-të përkatëse dhe institucionet arsimore.
- ◇ Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me MAS-in për nevojat që lidhen me zbatimin e programit.
- ◇ Cakton një koordinator në nivel kombëtar për orientimin për karrierën.

- ✧ Mbështet koordinatorët e DRAP-ve, ZVAP-ve dhe institucioneve arsimore për orientimin për karrierën.
- ✧ Grumbullon (koordinatori i DPAP-së për orientimin për karrierën), çdo tre muaj, raportet e DRAP-eve dhe përgatit raportin përmbledhës të ecurisë së veprimtarive për orientimin për karrierën, të cilin e dorëzon në MAS.
- ✧ Mbështet ngritjen e kapaciteteve të drejtuesve të institucioneve arsimore dhe të koordinatorëve të institucioneve arsimore për orientimin për karrierën.
- ✧ Përfshin në platformat e monitorimit procesin e orientimit në karrierë të organizuar në nivel shkolle dhe në nivel lokal.

7.4. AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT

PARAUNIVERSITAR (ASCAP)

Për realizimin sa më cilësor dhe efektiv të veprimtarive për orientimin për karrierën, ASCAP angazhohet:

- ✧ Të mbështesë zhvillimin profesional të koordinatorëve të orientimit të karrierës në DRAP-e, ZVAP dhe shkollë, të drejtuesve të institucioneve arsimore për realizimin e veprimtarive për orientimin për karrierën.
- ✧ Të hartojë module trajnimi për zhvillimin profesional të kapaciteteve të institucioneve arsimore për orientimin për karrierën.
- ✧ Të hartojë materiale mbështetëse për koordinatorët e orientimit për karrierën dhe punonjësit arsimorë të angazhuar në zhvillimin e veprimtarive në institucionet arsimore.
- ✧ Të monitorojë dhe të mbështesë institucionet arsimore në procesin e realizimit të veprimtarive për orientimin e nxënësve për karrierën.

8. SHTOJCA 1

Emri i nxënësit: _____

Klasa: VI _____

Shkolla: _____

Viti shkollor: _____

FORMULARI I AFTËSIVE DHE I PRIRJEVE TË NXËNËSIT PËR KLASËN VI

Nr.	Aftësitë dhe prirjet e nxënësit	Përzgjidh aftësitë dhe prirjet e nxënësit dhe shëno me ✓
1.	Është kërkues, krijues dhe angazhohet duke eksperimentuar dhe zbuluar njohuri të reja në shkencat e natyrës (p.sh., biologji, fizikë, astronomi etj.).	
2.	I pëlqen matematika, të bëjë përlogaritje dhe të marrë pjesë në konkurse, olimpiada, klube etj.	
3.	I pëlqen të shprehë krijimtarinë e tij përmes shkrimeve të poezive, prozave, eseve, si dhe të marrë pjesë në konkurse, gazetën e shkollës, olimpiada, klube.	
4.	I pëlqen të shprehë krijimtarinë e tij përmes vizatimeve, pikturës, dizajnit etj., dhe të marrë pjesë në konkurse, panairë, ekspozita.	
5.	Ka talent në muzikë dhe i pëlqen të shprehë krijimtarinë e tij përmes muzikës/kërcimit/këngës/instrumenteve/aktrimit dhe të marrë pjesë në konkurse, shfaqje, aktivitete etj.	
6.	Shpreh interes për vendet të ndryshme, historinë, kulturat dhe gjuhët e tyre.	
7.	Ka aftësi sipërmarrëse, merr iniciativa të organizojë veprimtari me klasën, dhe të angazhohet në klubet shkollës.	
8.	I pëlqejnë aktivitetet fizike dhe sportive dhe merr pjesë në to. Shpesh angazhohet në aktivitete natyrore (p.sh., shëtitje, lojëra, kampe etj.).	

9.	I pëlqen të kujdeset për bimët dhe kafshët, të eksplorojë natyrën dhe të kujdeset për mjedisin. Angazhohet në aktivitetet e kopshtarisë në shkollë.	
10.	I pëlqen të eksplorojë dhe të marrë pjesë në konkurse, panairë me punime dore si p.sh., qepje, qëndisje, punime me baltë, me dru ose me ndonjë material tjetër.	
11.	Ka interes për kuzhinën, i pëlqen të eksperimentojë me gatimin dhe të provojë receta të reja.	
12.	Ka aftësi të mira në përdorimin e teknologjisë dhe i pëlqen të ndjekë programe të ndryshme kompjuterike.	
13.	Shpreh interes dhe kujdeset për shokët dhe shoqet e klasës, është empatik, kujdeset për të moshuarit dhe për njerëzit në nevojë.	
14.	Bashkëpunon me shokët gjatë punëve në grup, është tolerant dhe i hapur ndaj mendimeve të të tjerëve dhe angazhohet në zgjidhjen e konflikteve në klasë me shokët dhe shoqet.	
15.	Të tjera ... (Ju lutem specifíkoni cilësi, interesa dhe prije të tjera, nëse ka)	

Mësuesi kujdestar

9. SHTOJCA 2

Emri i nxënësit: _____

Klasa: VII _____

Shkolla: _____

Viti shkollor: _____

FORMULARI I AFTËSIVE DHE I PRIRJEVE TË NXËNËSIT PËR KLASËN VII

Nr.	Aftësitë dhe prirjet e nxënësit	Përzgjidh aftësitë dhe prirjet e nxënësit dhe shëno me ✓
1.	Ka aftësi sipërmarrëse, merr iniciativa të organizojë veprimtari me klasën, dhe me shkollën. Shpreh interes të hartojë një plan të thjeshtë veprimtarish.	
2.	I pëlqen të angazhohet me përgatitjen e gatimeve të ndryshme (p.sh. në panairin e produkteve të kulinarisë në shkollë), me shtrimin e tavolinave dhe dekorimin e tyre, me shërbimin e produkteve etj.	
3.	I pëlqen të hulumtojë rreth vendeve turistike, objekteve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe t'u prezantojë të tjerëve informacion rreth tyre.	
4.	Shpreh interes dhe angazhohet në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, shfaq aftësi krijuese në krijimin e produkteve digjitale si p.sh., blogje, forume, media sociale etj.	
5.	Shfaq interes dhe angazhohet në mirëmbajtjen e pajisjeve dhe orendive të klasës, përdor vegla të thjeshta për mirëmbajtjen dhe riparimin.	
6.	I pëlqen të zbukurojë mjediset e klasës dhe të shkollës me bimë dhe lule dekorative dhe kujdeset për parcelën e shkollës. Kujdeset për kafshët, për udhëqimin dhe higjienën e tyre.	

7.	I pëlqen të stillojë modele të thjeshta veshjesh, angazhohet në arredimin e mjediseve të klasës ose të mjediseve të veçanta të shkollës, p.sh., skenën e një shfaqjeje.	
8.	Shtfaq interes dhe pritje për t' u shprehur përmes vizatimit/pikturës/këngës/kërcimit/lojës në role. I pëlqen të eksplorojë me krijimet e tij, duke punuar në mënyrë të pavarur dhe në grup.	
9.	I pëlqen të jetë i aktivizuar në klubet sportive në shkollë, të marrë pjesë në gara, kampionate të shkollave etj.	
10.	Tregon kujdes për anëtarët e familjes, shokët dhe shoqet, fëmijët në nevojë, të moshuarit.	
11.	Të tjera... (Ju lutem specifikoni interesa dhe pritje të tjera, nëse ka).	

Mësuesi kujdestar

10. SHTOJCA 3

Emri i nxënësit: _____

Klasa: VIII _____

Shkolla: _____

Viti shkollor: _____

FORMULARI I AFTËSIVE DHE I PRIRJEVE TË NXËNËSIT

PËR KLASËN VIII

Nr.	Fusha ose Drejtime profesionale	Aftësitë dhe prirjet e nxënësit	Përzgjidh aftësitë dhe prirjet e nxënësit dhe shëno me ✓
1.	Ekonomi, biznes, sipërmarrje	Angazhohet në veprimtari sipërmarrëse që kërkojnë përdorimin e aftësive matematikore, të përllogaritjeve të kostove të thjeshta, të marketingut etj., si p.sh., përllogaritja e kostove të thjeshta në organizimin e një aktiviteti/projekti kurrikular, etj.	
2.	Turizëm, hoteleri, kulinari, teknologji ushqimore	Merr pjesë në organizimin e ekskursioneve, krijon një guidë të thjeshtë të vendeve/pikave që do të vizitojnë dhe paraget informacion para grupit për vendet, pikat, objektet që vizituan.	
3.	Teknologji informacioni dhe komunikimi, elektronikë	Angazhohet në përgatitjen e ushqimeve (p.sh. në panairin e gatimeve tradicionale në shkollë), ka njohuri në përgatitjen e recetave të ndryshme, njeh rregullat kryesore të etikës së shërbimit etj.	
		Angazhohet me dëshirë në përdorimin e pajisjeve digjitale dhe të programeve softuerike për të kryer detyra/projekte kurrikulare, për të kërkuar, përpunuar dhe prezantuar të dhëna etj. I pëlqen të jetë në kontakt me programet me të reja të	

		teknologjisë.	
4.	Shërtime të ndryshme (mekanike, elektrike, hidraulike, ndërtim, përpunim druri etj).	Shtfaq aftësi për punime të ndryshme elektrike, mekanike gjatë punëve të laboratorit, apo angazhohet në mirëmbajtjen e pajisjeve të klasës e të shkollës me riparime të thjeshta të tavolinave, të karrigeve, të stendave, etj.	
5.	Shërtime sociale dhe shëndetësore	Ndërmerr iniciativa për t'u kujdesur dhe për t'u ardhur në ndihmë të moshuarve, fëmijëve në nevojë dhe personave të tjerë me probleme sociale dhe shëndetësore, si p.sh., tregon kujdes për shokët ose shoqet me probleme shëndetësore etj.	
6.	Bujqësi	Angazhohet në mbijelljen dhe përkujdesjen ndaj bimëve, ka njohuri dhe shtfaq aftësi në lidhje me plehërimin, ujtjen etj. Kujdeset për mbrojtjen e mjedisit, njeh dhe promovon produktet organike bimore dhe shtazore.	
7.	Tekstile, dizajn	Kujdeset për katshët shtëpiake ose të tjera, për ushqyerjen, higjienën etj.	
8.	Arte	Skicon modele të ndryshme të veshjeve, të këpucëve, të aksesorëve të ndryshëm si çanta, kapele, shalle, bizhuteri etj., njeh dhe kombinon ngjyrat, materialet; shtfaq aftësi në qepje, thurje etj.	
9.	Sporte	Merr pjesë në eskpozita, konkurse, shtfaqje etj., me krijimet e tij artistike si, p.sh., pikturë, skulpturë, fotografi, krijime letrare.	
10.	Shkenca	Performon në forma të ndryshme të artit si në një instrument muzikor, në këngë, në kërcim etj.	
11.	Të tjera	Merr pjesë në klubin sportiv të shkollë, ka rezultate në garat dhe kampionatet sportive të shkollës.	
		Angazhohet dhe ka rezultate të mira në olimpiada, konkurse në fushën e shkencave dhe matematikë.	
		(Ju lutem specifikoni interesa dhe prijje të tjera, nëse ka)....	

Mësuesi kujdestar

11. SHTOJCA 4

FORMULAR I ORIENTIMIT TË NXËNËSIT PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË²

Emri i nxënësit: _____

Klasa: IX

Shkolla: _____

Viti shkollor: _____

Në përfundim të arsimit bazë, nxënësi orientohet/sugjerohet të ndjekë llojin e arsimit të mesëm³: _____

Gjimnazin	Arsimin e mesëm të orientuar	Arsimin e mesëm profesional ⁴
	Muzikë	Teknologji ushqimore
	Art Figurativ	Ndërtim
	Koreografi	Përpunim druri
	Sporte	Tekstil konfeksione
	Gjuhë të huaja	Elektroteknikë
		Mekanikë
		Hoteleri turizëm
		Bujqësi
		Ekonomi biznes
		Shërbime mjetesesh transporti
		Veterinari
		Shërbime sociale dhe shëndetësore
		Pyje
		Teknologji informacioni dhe komunikimi
		Termohidraulikë

Mësuesi kujdestar

² Në përfundim të klasës së 9-të, mësuesi kujdestar plotëson formularin përfundimtar "Formular i orientimit të nxënësit për arsimin e mesëm të lartë". Në këtë formular mësuesi orienton/sugjeron nxënësit dhe prindërit për llojin e arsimit të mesëm të lartë bazuar në rezultatet mësimore si dhe në aftësitë, prirjet dhe interesat e nxënësit të evidentuara në klasat 6,7,8 dhe në suplementin e klasës së 9-të të plotësuar nga mësuesi.

³ Në këtë rubrikë vendoset lloji i arsimit të mesëm të lartë që mund të ndjekë nxënësi pas përfundimit të klasës së 9-të: Gjimnaz , Arsim i mesëm i orientuar, Arsim i mesëm profesional.

⁴ Në këtë rubrikë përzgjidhet duke vendosur shenjën (✓) drejtimi përkatës për llojin e arsimit të mesëm të lartë.

Suplementi: Tabela e aftësive dhe prirjeve të nxënësit⁵

Nr.	Fusha/Drejtme profesionale	Aftësitë dhe prirjet e nxënësit	Përzgjidh aftësitë dhe prirjet e nxënësit dhe shëno me ✓
1.	Ekonomi, biznes, sipërmarrje	Angazhohet në veprimtari që kërkojnë përllogaritje të kostos, të fitimit, të marketingut etj. I pëlqen të eksplorojë përdorimin e platformave të mediave sociale për promovimin e produkteve ose të ideve etj.	
2.	Turizëm, hoteleri, kulinari, teknologji ushqimore	Krijon guida për udhëtimet, ekskursionet dhe aktivitetet e tjera që organizon klasa/shkolla, duke përcaktuar vendet, objektet që do të vizitojnë, mbledh informacion dhe e prezanton para grupit të shokëve dhe shoqeve. Angazhohet në përgatitjen e recetave dhe produkteve të ndryshme të gatimit (p.sh., me bazë brumi, perime etj), përgatit menu të thjeshta për ngjarje të veçanta si p.sh., ditëlindje etj. Shërben me etikë recetat e përgatitura.	
3.	Teknologji informacioni dhe komunikimi, elektronikë	Demonstron aftësi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, në përdorimin e pajisjeve kompjuterike dhe elektronike. Ndjek me interes programet e reja në këtë fushë dhe angazhohet në përdorimin e platformave të ndryshme si, p.sh. kodimin, robotikën, inteligjencën artificiale etj. Angazhohet me dëshirë në mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike të klasës/shkollës.	
4.	Shërbitime të ndryshme (mekanike, elektrike, hidraulike, ndërtim, përpunim druri etj).	Shfaq aftësi për punime të ndryshme elektrike, mekanike gjatë punëve të laboratorit, apo angazhohet në mirëmbajtjen e pajisjeve të klasës e të shkollës me riparime të thjeshta të tavolinave, të karrigëve, të stendave, etj. Gjatë veprimtarive që zhvillohen në kuadër të orientimit të karrierës, shfaq interes për ndërtimin dhe funksionimin e mjeteve të transportit si p.sh., biçikleta, motor, makina etj.	

⁵ Në suplement, mësuksi vendos shenjtën (✓) në aftësitë, prirjet dhe talentet që janë pika të forta për nxënësin.

5.	Shërbime sociale dhe shëndetësore	Shfaq empati dhe kujdes për fëmijët në nevojë dhe persona të tjerë me probleme sociale dhe shëndetësore. Angazhohet si vullnetar dhe ndërmerr iniciativa në mbledhjen e fondeve për persona në nevojë. Krijon animacione, fletëpalosje me informacione ndërgjegjësuese etj., për çështje të ndryshme të shëndetit ose të kujdesit social si p.sh., për rëndësinë e dhurimit të gjakut etj.	
6.	Bujqësi	Angazhohet në plehërimin, ujëtimin, kultivimin e bimëve e produkteve të ndryshme si p.sh., të perimeve, luleve në kopshtin e shkollës etj. Kujdeset për mbrojtjen e mjedisit, angazhohet në fushata të mbjelljes së pemëve. Kujdeset për kafshët shtëpiake ose të tjera, për ushqyerjen, higjienën, vaksinimin etj.	
7.	Tekstile, dizajn	Shfaq origjinalitet në skicimin dhe krijimin e modeleve të ndryshme të veshjeve, të këpuçëve, të aksesorëve të ndryshëm si çanta, kapele, shalle, bizhuteri etj., njëh motivet popullore dhe tendencat bashkëkohore dhe i reflekton ato në kombinimin e ngjyrave dhe materialeve.	
8.	Arte	Shfaq origjinalitet në krijimet e tij të cilat i paraqet në ekspozita, konkurse, shfaqje etj. Performon në forma të ndryshme të artit si në pikturë, fotografi, skulpturë, prodhime qeramike, instrument muzikor, këngë, kërcim, aktim etj.	
9.	Sporte	Përfaqëson shkollën, qytetin, etj., në gara sportive. Ka rezultate në garat dhe kampionatet sportive të shkollës.	
10.	Shkenca	Angazhohet dhe ka rezultate të mira në olimpiada, konkurse në fushën e shkencave dhe matematikë.	
11.	Komunikimi	Demonstron aftësi të mira komunikuese, debatuase dhe prezantuese si dhe zotëron aftësi të mira në drejtimin e grupeve të punës, qeverisë së nxënësve etj.	
12.	Të tjera	(Ju lutem specifikoni interesa dhe priqje të tjera, nëse ka) ...	

Mësuesi kujdestar